



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATE/A:	25.04.2025
REFERENC-Ë:	24/7495/MMPHI
PËR/ZA/TO:	"ETI" Sh.p.k. Konjuh, Lipjan, Eksplotim i gurit gëlqeror në Parallovë, Novobërdë
CC:	Komisioni për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës së MMPHI-së
NGA/OD/FROM:	Izedin Bytyqi, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për vazhdimin e Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), ka shqyrtuar kërkesën për tu pajisur me Leje Mjedisore të operatorit "ETI" Sh.p.k. Konjuh, Lipjan, me Nr. Prot. 24/7496/MMPHI dhe ka vendosur si ne Vendim për Leje Mjedisore të bashkangjitur kësaj shkrese përcjellëse.

Me respekt!



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine, Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment, Spatial Planning and Infrastructure

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

Nr.: 24/7495/MMPHI
Datë: 25.04.2025

Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në mbështetje të nenit 18 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 7/01 Mars 2019), shtojcës 1 pika 10 të Rregullores (QRK) Nr. 14/2023 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenit 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, paragrafi, 1, 2 dhe 4 të nenit 12, neni 17, paragrafi 2 dhe nenit 9 paragrafi 1.4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Operatorit "ETI" Sh.p.k. Konjuh, Lipjan, me Nr. Prot. 24/7496/MMPHI i vazhdohet Leja Mjedisore, për veprimtarinë: Eksploatim i gurit gëlqeror, në pjesën e ngastrave nr. 1279, nr. 1305, në sipërfaqe prej 02.77.60 ha zona kadastrale Parallovë.
2. Operatori obligohet:
 - 2.1. Të bënë monitorimin e vazhdueshëm të pajisjeve, respektivisht përmbushjes së kërkesave teknike;
 - 2.2. Të mirëmbahet thurja e ngastrës ku bëhet shfrytëzimi i gurit gëlqeror;

- 2.3. Të i përmbahet kushteve të shfrytëzimit të gurit gëlqeror sipas përshkrimit në aplikacion;
- 2.4. Për sistemin menaxhues mjedisore të këtë personin e profilit mjedisor;
- 2.5. Vazhdimisht të behët spërkatja me ujë e rrugëve të pa asfaltuara të cilat shfrytëzohen për bartjen e gurit gëlqeror;
- 2.6. Pas përfundimit të aktivitetit të bëhet rehabilitimi dhe rikultivimi i zonës sipas kritereve ligjore dhe përshkrimit në aplikacion;
- 2.7. Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPHI.

A r s y e t i m

Është shqyrtuar kërkesa për Leje Mjedisore për operatorin "ETI" Sh.p.k. Konjuh, Lipjan, me Nr. Prot. 24/7496/MMPHI, për veprimtarinë: Eksploatim i gurit gëlqeror në ngastrën nr.1279, nr. 1305, në sipërfaqe prej 02.77.60 ha zona kadastrale Parallovë, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe vizitës në terren, MMPHI konstaton se operatori i lartcekur, i plotëson kushtet administrative dhe mjedisore për vazhdimin e Lejes Mjedisore.

Operatori ka bashkangjitur dokumentacionin:

- Aplikacionin e plotësuar në pesë kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr.13/99, të dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kritereve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit;
- Pëlqim Mjedisor me Nr.17/4373/1-ZSP/244/17, të lëshuar me dt.08.09.2017;
- Licencë e shfrytëzimit 2150/KPMM/2020, me nr. prot. 3621, të lëshuar me datë: 30.09.2020, me afat të vlefshmërisë gjer me: 01.09.2030;
- Njoftim nga komuna Novobërdë me nr. prot.2382 , të datës:12.10.2017, për shfrytëzimin e përkohshëm të parcelës.

Andaj bazuar ne dokumentacionin e dorëzuar nga pala dhe gjendjes faktike duke përfshi shikimin ne vend me zyrtaret profesional sipas legjislacionit ne fuqi për mjedisin dhe Udhëzimit Administrativ te MMPHI- se Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore janë paraqitur kushtet si ne dispozitë.

Afati i përcaktuar i lejes mjedisore ne dispozite është përcaktuar, në përputhje të nenit 31 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtje e Mjedisit dhe nenit 12 paragrafi 4 të Udhëzimit Administrativ MMPHI Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Izedin Bytyqi

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPHI-së

Vendimi i dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës- Novobërdë;
- DMMU-së;
- Inspektoratit të MMPHI-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPHI-së;
- Arkivit të MMPHI-së.